

Revista Sot

Në janar të vitit 2011 Revista "Ekonomia dhe Tranzicioni" ka ndryshuar emrin në "Revista Shqiptare Social Ekonomike" duke synuar që përveç kontributit akademik të zgjerojë fokusin e botimeve të saj edhe në problemet e politikave ekonomike, sociale, juridike, ambientale, etj. në fazën e sotme të zhvillimit të ekonomisë sonë kombëtare dhe të integritit European të saj. Për të njëjtin qëllim është bërë edhe rikompozimi i Këshillit Botues duke përfshirë në të edhe studiues të huaj të mirënjohur për kontributet e tyre në çështjet e tranzicionit drejt ekonomisë së tregut në tërësi, si dhe në çështjet specifike të këtij procesi në ekonominë shqiptare dhe të rajonit tonë në veçanti.

Në qendër të vëmendjes do vazhdojnë të jenë sfidat e ekonomisë shqiptare, por gjithashtu do zgjerohet edhe hapësira që do zënë çështjet sociale, duke mbajtur parasysh që tashmë vendi ynë ndodhet në stad të avancuar të zhvillimit të tij, me të tjera problematika dhe sfida të reja për t'u përballur.

Përfituesit kryesorë të botimeve të revistës

- Studiuesit e rinj të fushës së shkencave sociale, ekonomisë dhe historisë së tranzicionit Shqiptar drejt ekonomisë së tregut dhe shoqërisë së lirë;
- Specialistët dhe hartuesit e politikave publike në fushën e ekonomisë, financave, bankave, etj, në institucionet shtetërore qendrore dhe vendore;
- Stuđentët e universiteteve publike dhe private të vendit;
- Studiues të huaj të interesuar për zhvillimet makro dhe mikroekonomike në Shqipëri gjatë dy dekadave të para të tranzicionit;
- Rrjeti i bibliotekave shkencore dhe universitare të vendit dhe në rajonet e tjera ku jetojnë shqiptarët në Ballkanin Perëndimor (Kosovë, Maqedoni dhe Mal të Zi).

*Revista ka statusin e një Reviste Shkencore, e njohur nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës (MASH)
ISSN 2222-5846*

Përmbledhja e botimeve të Revistës dhe promovimi i saj u bë i mundur falë mbështetjes përmes një granti të Fondacionit ABC (Albanian Besa Capital), në sajë të programit "Qeverisja e Mirë" me projektin: "Edukimi Ekonomik përmes Revistës "Ekonomia dhe Tranzicioni".

Përmbledhja e botimeve në CD dhe Indeksi i artikujve të botuar deri më sot ka si qëllim të kontribuojë në sistemimin e materialeve të botuara në favor të administrimit dhe përdorimit për nevoja studimore të këtyre botimeve, si dhe njohjen dhe përdorimin e duhur të këtyre materialeve, duke i konsideruar një burim të dobishëm informacioni, të dhënash dhe analizash në fushën ekonomike dhe sociale që ka shoqëruar tranzicionin ekonomik të Shqipërisë gjatë këtyre 15 viteve të fundit.




Botuar me mbështetjen e Fondacionit ABC
Grant nr. 22. Datë 16.06.2011

REVISTA SHQIPTARE SOCIAL EKONOMIKE
(ndryshuar më 1 Janar 2011)

Revistë Social Ekonomike tremujore

Kolegjiumi i Redaksisë

Dr. Zef PREÇI – Kryeredaktor
Prof. Dr. Adrian CIVICI
Prof. Dr. Iraj HASHI
Prof. Dr. Fatmir MEMAJ – Sekretar i kolegjiumit
Prof. Dr. H.-Dieter WENZEL
Prof. Dr. Tomasz MROCZKOWSKI
Dr. Eliona BIMBASHI (KULLURI)
Dr. Grida DUMA (SHQINA)
Redaktore:
Jonida NARAZANI, M.A



REVISTA
"EKONOMIA DHE TRANZICIONI"
(1994 - 2010)

Prej 18 vjetësh në treg me rreth 900 artikuj të botuar!

Botim Periodik

Qendrës Shqiptare për Kërkime Ekonomike

Adresa:

Rr. "Perlat Rexhepi", Nr. 10, Kati 6, Ap. 64
Kutia Postare 2934, Tiranë, SHQIPËRI
Tel/Fax: 04 227 4 603
E-mail: acer@abcom.al
www.acer.org.al

Parathënie

Para dy dekadash, kur Shqipëria u fut në rrugën e ekonomisë së tregut dhe shoqërisë së lirë, askush nuk mund t'i parashikonte sfidat e vështirësitë e transformimeve sistemike që ndodhën gjatë kësaj periudhe. Megjithatë, të gjithë kemi kuptuar gjatë këtij procesi se e vetmja rrugë e mundshme për të cuar përpara ekonominë dhe shoqërinë shqiptare ishte dhe mbetet rruga e ekonomisë së tregut dhe e iniciativës së lirë, rivendosjes së lidhjeve ekonomike, politike dhe shoqërore me Europën perëndimore.

Veprimtaria kërkimore e këtyre viteve nuk kishte se si të mos reflektonte ndryshimet që po kalonte vendi ynë si në aspektin politik ashtu edhe në atë social-ekonomik. Analizat dhe studimet e shumta lidhur me ekonominë në tërësi dhe aspekte specifike të saj kishin nevojë për hapësirë ku të shpaloseshin, të diskutoheshin dhe të përmirësoheshin më tej. Pikërisht për këtë, Revista "Ekonomia dhe Tranzicioni" ka shërbyer si një mundësi modeste ku studiuesit, akademikët dhe personalitete të njohura kanë bërë publike gjetjet e kërkimeve dhe analizave të tyre duke shfaqur dhe përballur pikëpamje të ndryshme lidhur me çështje të vecanta të tranzicionit drejt ekonomisë së lirë. Kjo revistë ka qënë promovuese e ideve të reja, por mbi të gjitha mbështetëse dhe nxitëse e debatit lidhur me politikën publike. Në të njëjtën kohë, Revista ka shërbyer edhe si një pasqyrë e veprimtarisë së vetë Qendrës Shqiptare për Kërkime Ekonomike (QShKE) dhe e punimeve të ndryshme që burojnë nga zbatimi i projekteve të saj.

Pas një përvoje pune studimore dhe botuese të gjatë, pothuaj sa vetë periudha e tranzicionit në fushën e studimeve kërkimore dhe botuese, QShKE publikon një koleksion të përmbledhur të një pune 16-vjecare të botimeve të Revistës periodike (tre-mujore) "Ekonomia dhe Tranzicioni".

Revista Dje

Revista "Ekonomia dhe Tranzicioni" në periudhën 1994 – 2010 (ndryshuar në Janar 2011 në "Revista Shqiptare Social-Ekonomike") ka botuar 64 numra (deri në fund të vitit 2010), me gjithsej rreth 900 artikuj. Pjesa më e madhe, në përmbajtjen e tyre kanë trajtuar çështje studimore në sektorët më të rëndësishëm të ekonomisë sonë kombëtare si: sektori industrial, sektori bujqësor, sektori financiar, tregtia e jashtme, etj. Gjithashtu, tema të tjera të analizuar janë: punësimi dhe papunësia, mbrojtja sociale dhe përvojat botërore në zhvillimin e skemave të ndryshme, zhvillimi i turizmit, por edhe lufta kundër korrupsionit, çështjet fiskale, ekonomia informale, tregu i kapitaleve, probleme të mirë-qeverisjes, menaxhimi i sipërmarrjeve, etj.

Rreth 1/5 e totalit të të gjithë artikujve (180 artikuj) kanë në qendër të vëmendjes zhvillimin e sektorit industrial, organizimin e ndërmarrjeve dhe funksionimin e biznesit në një ekonomi tregu. Kjo është edhe e kuptueshme, duke qënë se ekonomia jonë kaloi nga një ekonomi që bazohej kryesisht në sektorin bujqësor, në një ekonomi të bazuar në importet, por me sektor të shërbimeve dhe turizmit në zhvillim e sipër dhe me një sektor industrial premtues.

Një pjesë e konsiderueshme e artikujve të botuar analizojnë sektorin financiar, si një nga sektorët më të rinj dhe më të panjohur më parë të ekonomisë shqiptare. Reformimi i sistemit bankar, ndryshimi i struktursë së tregut i shoqëruar me rritje të konkurrencës, ofrimi i produkteve dhe shërbimeve të reja, por edhe zhvillimi i tregjeve të sigurimeve dhe të pensioneve private kanë qënë shtysë për të orientuar vëmendjen drejt këtij tregu. Rreth 10% e artikujve (87 artikuj) kanë analizuar probleme të ndryshme të tregjeve financiare.

Nuk ka mbetur jashtë vëmendjes së studiuesve as sektori bujqësor, jo vetëm sepse ka qënë për shumë kohë kontribuesi kryesor në PBB-në vendase, por edhe për shkak të reformimeve të shumta që ka përjetuar dhe

problemeve që ende e karakterizojnë (rreth 10% të artikujve i përkasin këtij sektorit).

Në revistën "Ekonomia dhe Tranzicioni" nuk kanë munguar as publikimet e bazuara në kërkimet mbi problematika të vecanta të shfaqura gjatë procesit të gjatë të tranzicionit të ekonomisë tonë kombëtare. Pothuajse 1/6 e artikujve kanë marrë në shqyrtim problemet të tilla si: korupsioni, ekonomia informale, pronësisë, përvojat e vendeve të tjera në fushën e privatizimit, zhvillimit të tregtisë e bashkëpunimit ekonomik ndërkufitar, etj.

Në mënyrë të përmbledhur mund të konkludohet se publikimet e ndryshme kërkimore gjatë kësaj periudhe në revistën "Ekonomia dhe Tranzicioni" përgjithësisht kanë qënë në të njëjtën linjë me zhvillimet e ekonomisë shqiptare.

Përsa u takon autorëve në periudhën 1994 – 2010, revista numëron sot rreth 515 artikuj (45%) të cilët kanë vetëm 1 autor, 310 artikuj (34%) janë me bashkëautorësi (2 ose më shumë autorë), dhe 75 artikuj (9%) janë përkthime nga autorë të huaj për aspekte që kanë lidhje me ekonominë shqiptare si dhe deklarime të personaliteteve të njohura që kanë marrë pjesë në aktivitete të ndryshme të organizuara nga QShKE. Pjesa më e madhe e autorëve janë profesorë, doktorë, shkencëtarë/akademikë të afirmuar në fushat përkatëse, drejtues të institucioneve të larta shtetërore, por edhe studiues të rinj në procesin e përgatitjes së punimeve të doktoraturës, etj.